



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 485/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Prizren, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Prizren.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, nga subjekti politik LDK dega në Prishtinë, në të cilën theksohet se me datën 03.11.2013, në ora 12:45, në ditën e zgjedhjeve kemi vërejtur se në qendrën e votimit në ATMAXHË në Prizren 2039A, truproja e Ramadan Mujës, kandidat i PDK-së i cili ishte po nga i njëjti fshat nuk po largohet nga aty duke manifestuar presion. Sipas parashtruesit të janë bërë shkeljet e dispozitës ligjore nga neni 33 pika G si dhe me nenit 34.1 lidhur me nenin 34.2 të LZP-së.

PZAP-i për rastin në fjalë kërkoi informacion nga Policia e Kosovës, por në raportin e saj policia e Kosovës theksonte se nuk ka arritur që ta identifikoj personin për të cilën ka pretenduar pala ankuese në ankesën e saj.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 të LZP-së, parashihet se “ Mund të apelohe vendimet e PZAP-it sikurse PZAP-i, mund ti rishikoj cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar.

Në ankesën e parashtruar nga pala ankuese si dhe nga shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit.

Andaj PZAP-i, i mbi këtë baze si dhe duke u mbështetur edhe në raportin e policisë e cila nuk ka arritur që ta vërtetoj kryesin e supozuar vlerëson se ankesa në fjalë është e pabazë dhe e pa argumentuar mire, prandaj duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 3.6 pika c) Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 485/2013 më datën 07.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda njëzetekatër (24)orë nga momenti i marrjes së këtij vendimi nga PZAP-i.